

Nr. 10825 prot.
Dt. 31.12.2021

ALBPETROL sh.a

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur.....	5
Pasqyra e Pozicionit Financiar	10
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse.....	11
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto	12
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare.....	13
Shënimet Shpjeguese	14
1. Informacion i përgjithshëm.....	14
2. Bazat e përgatitjes	15
2.1. Deklarata e pajtueshmërisë	15
2.2. Baza e matjes.....	15
2.3. Parimi i vijimësisë	15
2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes.....	16
2.5. Vlerësime dhe gjykime	16
3. Standarde dhe interpretime të reja	16
3.1. Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020	16
3.2. Standardet e reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja të publikuara, por që ende nuk janë efektive	17
4. Politikat më të rëndësishme kontabël.....	18
4.1. Transaksionet në monedhë të huaj.....	18
4.2. Instrumentat financiarë	18
4.2.1 Njohja dhe çregjistrimi	18
4.2.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare	19
4.2.3 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare	19
4.2.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare	20
4.2.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.....	21
4.2.6 Llogari të arkëtueshme.....	21
4.2.7 Llogari të pagueshme.....	21
4.2.8 Hua të marra dhe të dhëna.....	21
4.3. Inventarët	22
4.4. Aktive afatgjata materiale	22
4.5. Aktive afatgjata jomateriale	24
4.6. Të ardhurat	24

4.6.1	Të ardhurat nga shitja e shërbimeve dhe produkteve	24
4.6.2	Të ardhurat nga Grantet	24
4.6.3	Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit	25
4.6.4	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.....	25
4.7.	Grantet.....	25
4.8.	Qiratë	25
4.9.	Tatimi mbi fitimin.....	25
4.10.	Përfitimet e punonjësve.....	26
4.11.	Provizionet	26
4.12.	Transaksionet me palët e lidhura	26
4.13.	Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara	27
4.14.	Krahasueshmëria e informacionit kontabël.....	27
5.	Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit.....	27
5.1.	Të ardhura nga kontratat hidrokarbure	27
5.2.	Grantet.....	27
5.3.	Provizionet	28
5.4.	Zhvlerësimi i inventarëve.....	28
5.5.	Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme.....	28
5.6.	Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë	28
6.	Aktivitet afatgjata materiale.....	29
7.	Aktive afatgjata jomateriale.....	30
8.	Aktive Biologjike	31
9.	Inventarë	31
10.	Shpenzime të shtyra	31
11.	Llogari të arkëtueshme tregtare	32
12.	Llogari të arkëtueshme të tjera.....	32
13.	Mjete monetare në arkë e në bankë.....	33
14.	Kapitali	33
15.	Primet e lidhura me kapitalin.....	34
16.	Rezerva rivlerësimi	34
17.	Rezervat e kapitalit.....	35
18.	Fitim/(Humbjet) e mbartura.....	36
19.	Hua bankare	36
20.	Provizione	38
21.	Detyrime të tjera.....	38

22.	Grante dhe të ardhura të shtyra	39
23.	Llogari te pagueshme tregtare afatshkurtra	39
24.	Llogari të pagueshme të tjera.....	39
25.	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	40
26.	Puna e kryer nga njesia dhe qe kapitalizohet.....	40
27.	Të ardhura të tjera	40
28.	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	41
29.	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	41
30.	Shpenzime personeli	42
31.	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale.....	42
32.	Shpenzime të tjera të shfrytëzimit.....	42
33.	Të ardhura dhe shpenzime interesi dhe të ngjashme.....	43
34.	Tatimi mbi fitimin	44
35.	Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin.....	44
36.	Manaxhimi i riskut financiar	44
37.	Transaksionet me palët e lidhura.....	48
38.	Angazhime dhe pasiguri	48
39.	Ngjarje pas datës së raportimit financiar	49

AUDITUES LIGJORE**Sokol Toska**Rr. Tish Dahia, Komp. Kika
2, Kulla 2, Nr.33, Tiranë**Nexhmije Çela**Rr. Brigada 8, Pallati 8/1,
Ap. 14, Tiranë**Aida Maloku**Lagja Kastrioti, Rr.
Brigada e 11 Sulmuese,
Pallati nr. 58, Kati 2, Fier**Njazi Laze**Lagja Konferenca e
Pezes, Pallatet Mertiri,
Nr.1, Fier**Ardiola Huta**Rr. Abdi Toptani, Torre
Drin, Kati i dyte, Tiranë

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Drejtuesit dhe Aksionerin e ALBPETROL sh.a.

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albpetrol sha (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në "Bazat për Opinionin me rezerve", pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2020, dhe performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin me Rezervë

1. Në shënimin 6 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020, "Aktivet Afatgjata Materiale" paraqiten me vlerën 31,401,901 mijë lekë (2019: 33,666,350 mijë lekë).

Shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit për të matur vlerën e Aktiveve Afatgjata Materiale duke i paraqitur me vlerën e drejtë. Në rastet kur shoqëria paraqet aktivet afatgjata me vlerën e drejtë me modelin e rivlerësimit, për secilën kategori të rivlerësuar të aktiveve afatgjata materiale, ajo duhet të japë informacione në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vlerën kontabël (neto) që do të ishte njohur sikur aktivet të mateshin pas njohjes duke përdorur modelin e kostos. Ky informacion mungon në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020. Për më tepër, në regjistrin e aktiveve duhet të paraqiten në mënyrë analitike vlerat historike dhe teprica e rivlerësimit me lëvizjet e periudhës. Këto informacione nuk janë të plota në regjistrin e aktiveve.

Kategoritë troje dhe ndërtesa nuk janë të mbështetura plotësisht në dokumenta pronësie. Për këtë arsye, vlera e tokës në shumën 8,214,405 mijë lekë nuk është regjistruar në kapitalin themelues por është mbajtur në një llogari të vecantë për të identifikuar këtë fakt. Për më tepër, ka raste ku sipërfaqet e paraqitura në kontabilitet janë të ndryshme me vërtetimet hipotekore, si dhe ka raste të zaptimit të tokave dhe ndërtesave apo edhe ndërtime pa leje brenda sipërfaqeve të njëjve.

Në grupin aktive afatgjata materiale, për vlerën 344,365 mijë lekë (2019: 352,298 mijë lekë), paraqiten banesat e ndërtuara nga shoqëria, të cilat nuk zotërohen më por i kanë kaluar në pronësi Entit të Banesave. Në këto rrethana shoqëria duhet të zbatojë kërkesat e SNK 16 duke njohur vlerën prej 344,365 mijë lekë në pakësim të aktiveve afatgjata materiale.

2. Në shënimin 12, "Llogari të arkëtueshme të tjera", pasqyra e pozicionit financiar, paraqitet në vlerën 4,203,422 mijë lekë (2019: 3,588,920 mijë lekë). Në këtë vlerë përfshihen si vijon:

Të drejta ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure, në vlerën neto 3,408,472 mijë lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: 2,740,630 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë vlerën përkatëse të sasisë së produktit që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrolit. Këto vlera nuk konfirmohen si detyrim nga ana e

AUDITUES LIGJORE

Sokol Toska Rr.Tish Dahia, Komp. Kika 2, Kulla 2, Nr.33, Tiranë	Nexhmije Çela Rr. Brigada 8, Pallati 8/1, Ap. 14, Tiranë	Aida Maloku Lagja Kastrioti, Rr. Brigada e 11 Sulmuese, Pallati nr. 58, Kati 2, Fier	Njazri Laze Lagja Konferenca e Pezes. Pallatet Mertiri, Nr.1, Fier	Ardlola Huta Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati i dyte, Tiranë
--	---	--	--	---

kontraktoreve, janë të kontestuara ose janë kundërshtuara në rrugë ligjore prej tyre. Shoqëria ka krijuar provizione vetëm për vlerën 200,000 mijë lekë lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.

Të drejta ndaj të tretëve për hua të dhëna me kontratë huaje sipas urdhërave të aksionarit në vlerën 652,634 mijë lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: 666,468 mijë lekë). Për shkak se njësitë për të cilat janë dhënë huatë janë shoqëri të cilat i kanë pushuar aktivitetet, nuk shihen mundësi për arkëtimin e tyre. Shoqëria ka krijuar provizione vetëm për vlerën 112,880 mijë lekë lidhur me pasigurinë për arkëtimin e këtyre të drejtave.

Kërkesa të tjera mbi një vit në vlerën 1,438,450 mijë lekë më 31 dhjetor 2020 dhe 1,316,779 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2019. Këto llogari përfshijnë mardhënie me persona dhe palë të treta, debitorë të ndryshëm, të drejta ndaj autoritetit tatimor të pakonfirmuara, të drejta ndaj kontraktorëve për inventare si dhe balanca të trashëguara nga ristrukturimet e mëparshme të shoqërisë. Këto të drejta janë mjaft të vjetra, të pakonfirmuara dhe balancat e trashëguara nga ristrukturimet janë pa informacione të plota për origjinën dhe natyrën e tyre. Për këto të drejta për arkëtim ekzistojnë të krijuara provizione për pasiguri të realizimit të tyre në vlerën 983,254 mijë lekë dhe këto të drejta rezultojnë në pasqyra në vlerën neto prej 455,195 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2020 (2019: 333,525 mijë lekë). Ne nuk ishim në gjendje të krijojmë siguri të arsyeshme për ekzistencën dhe vlerën neto të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë.

3. Në shënimin 9 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2020 inventari paraqitet në vlerën 3,725,152 mijë lekë (2019: 3,308,794 mijë lekë). Për shkak se ne u emëruam si auditues në datën 22 shkurt 2021, ne nuk ishim të pranishëm në procesin e inventarizimeve vjetore të cilat shoqëria i ka realizuar në periudhën tetor 2020. Me gjithë procedurat e tjera të zbatuara, për shkak edhe të natyrës së regjistrimeve të shoqërisë si edhe për shkak të mënyrës së ruajtjes së inventarëve, ne nuk mundëm të siguroheshim nëpërmjet evidencës së duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me sasi të inventarit në datën 31 Dhjetor 2020.

Për më tepër, shoqëria trashëgon inventare jashtë përdorimit apo të papërdorshëm për shkak të teknologjisë dhe vjetërimit, në vlerën 1,459,691 mijë Lekë, për të cilët shoqëria ka njohur zhvlerësime vetëm për vlerën 137,487 mijë Lekë në periudha të mëparshme. Këto inventarë janë identifikuar por nuk është kryer llogaritja dhe paraqitja e zhvlerësimit të plotë në datën e pasqyrave financiare më 31 dhjetor 2020. Në pajtim me parashikimet në SNK 2 "Inventarët", kur inventarët dëmtohen, janë bërë tërësisht ose pjesërisht të vjetëruar ose nëse çmimet e shitjes së tyre kanë rënë, shoqëria duhet të kryejë zhvlerësimin e inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme. Për këtë arsye, ne nuk mund të përcaktojmë efektet që mund të shkaktohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, si rrjedhojë e rregulimeve që mund të jenë të nevojshme të kryhen për inventarët.

4. Në shënimin 11, "Llogari të arkëtueshme tregtare", në pasqyrën e pozicionit financiar, paraqitet shuma 18,110,942 mijë lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: 17,382,762 mijë lekë). Për këto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme për saktësinë e tyre, as nëpërmjet procedurave të letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Shoqëria nuk ka bërë teste zhvlerësimi dhe nuk ka llogaritur zhvlerësim për kërkesat e arkëtueshme, por ka paraqitur si zhvlerësim pergjithesisht llogaritë që janë me një vjetërsi mbi 5 vjet dhe që mundësitë e arketimit të këtyre llogarive janë konsideruar nga drejtimi si pa shprese. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që mund të rezultojnë nga korrigjimet e mundshme të tyre, në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

AUDITUES LIGJORE

Sokol Toska Rr. Tish Dahia, Komp. Kika 2, Kulla 2, Nr.33, Tiranë	Nexhmije Çela Rr. Brigada 8, Pallati 8/1, Ap. 14, Tiranë	Aida Maloku Lagja Kastrioti, Rr. Brigada e 11 Sulmuese, Pallati nr. 58, Kati 2, Fier	Njazi Laze Lagja Konferenca e Pezes, Pallatet Mertiri, Nr.1, Fier	Ardiola Huta Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati i dyte, Tiranë
---	---	--	---	---

5. Në shënimin 23 të pasqyrave financiare, gjendja e llogarive tregtare të pagueshme afatshkurtra paraqitet në vlerën 10,369,352 mijë lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: 9,131,268 mijë lekë). Per keto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme për saktësinë e tyre, as nëpërmjet procedurave te letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare te mbyllura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

6. Në shënimin 21, në pasqyren e pozicionit financiar, paraqiten “Detyrime të tjera”, në vlerën 240,099 mijë lekë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019. Këto balanca shfaqen si kundërvlerë e aktiveve, të cilat nuk disponohen më nga shoqëria apo janë jashtë përdorimit. Në këto rrethana shoqëria duhet të zbatojë kërkesat e SNK duke njohur këto vlera në pakësim të aktiveve përkatëse dhe jo si detyrime. Për rrjedhojë Aktivitet dhe Detyrimet janë të mbivlerësuara për 240,099 mijë lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: 240,099 mijë lekë).

7. Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 12 “Tatimi mbi te ardhurat” kërkon që Shoqëria të njohë tatime të shtyra, si efekt tatimor mbi diferencat midis vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata materiale të rivlerësuara dhe bazës tatimore. Shoqëria nuk ka llogaritur tatimin e shtyrë. Për sa më sipër, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që kjo përlllogaritje do të kishte në pasqyrat financiare të Shoqërise në 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Informacione të tjera të Raportuara në Përputhje me Kuadrin Ligjor e Rregullator në Fuqi

Drejtimi ka përgjegjësinë për përgatitjen dhe raportimin e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera, të cilat përfshijnë Raportin e Ecurisë së Veprimtarisë, Raportin Jofinanciar, Raportin e Drejtimit të Brendshëm dhe Raportin e Pagesave që u bëhen Institucioneve Shtetërore, përgatiten në zbatim të Ligjit 25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe nuk përfshijnë pasqyrat financiare bashkëngjitur dhe as raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera të dhëna në raportet e mësipërme dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni i cili të japë siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare nga ana jonë, ne kemi përgjegjësinë për të lexuar informacionet e tjera dhe në këtë proces duhet të konsiderojmë nëse informacionet e tjera janë materialisht kontradiktore me paraqitjet në pasqyrat financiare apo njohuritë që ne kemi marrë gjatë auditimit, apo kanë pasaktësi të tjera materiale. Nëse bazuar në punën që kemi kryer mbi informacionet e tjera të siguruar para datës së këtij raporti të audituesit, ne arrijmë në konkluzione

AUDITUES LIGJORE

Sokol Toska Rr. Tish Dahia, Komp. Kika 2, Kulla 2, Nr. 33, Tiranë	Nexhmije Çela Rr. Brigada 8, Pallati 8/1, Ap. 14, Tiranë	Aida Maloku Lagja Kastrioti, Rr. Brigada e 11 Sulmuese, Pallati nr. 58, Kati 2, Fier	Njazi Laze Lagja Konferenca e Pezes. Pallatet Mertiri, Nr. 1, Fier	Ardiola Huta Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati i dyte, Tiranë
--	---	--	--	---

se në këto informacione ka pasaktësi materiale, ne jemi të detyruar ta raportojmë këtë fakt. Sic përshkruhet në paragrafin Bazat per Opinionin me Rezervë pasqyrat financiare përmbajnë disa pasaktësi materiale, të cilat janë listuar në atë paragraf. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të sigurohemi nëse edhe informacionet e tjera përmbajnë pasaktësi materiale që lidhen me ato çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi, duke dhënë informacione shpjeguese për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Organet e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.


Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

• Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

• Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

• Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë.



AUDITUES LIGJORE

Sokol Toska Rr. Tish Dahia, Komp. Kika 2, Kulla 2, Nr. 33, Tiranë	Nexhmije Çela Rr. Brigada 8, Pallati 8/1, Ap. 14, Tiranë	Aida Maloku Lagja Kastrioti, Rr. Brigada e 11 Sulmuese, Pallati nr. 58, Kati 2, Fier	Njazi Laze Lagja Konferenca e Pezes. Pallatet Mertiri, Nr. 1, Fier	Ardiola Huta Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati i dyte, Tiranë
--	---	--	--	---

Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

• Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

31 Dhjetor 2021

AUDITUESIT LIGJORË


Sokol Toska

Nexhmije Çela

Aida Maloku

Njazi Laze

Ardiola Huta



NJAZI LAZE
EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR



Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktivët afatgjata			
Aktivët afatgjata materiale	6	31,401,901	33,666,350
Aktivët afatgjata jomateriale	7	83,453	109,262
Aktive biologjike	8	108	109
Totali i aktiveve afatgjata		31,485,462	33,775,721
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	9	3,725,152	3,308,794
Shpenzime të shtyra	10	0	43,238
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	18,110,942	17,382,782
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	4,203,422	3,588,920
Mjetet monetare dhe ekulvalentë të tyre	13	1,204	635,218
Totali i aktiveve afatshkurtra		26,040,720	24,958,932
Totali i aktiveve		57,526,182	58,734,653
KAPITALI DHE DETYRIMET			
KAPITALI			
Kapitali themeltar	14	14,735,229	14,735,229
Prime të lidhura me kapitalin	15	8,214,405	8,361,235
Rezerva rivleresimi	16	24,303,133	25,740,916
Rezerva ligjore	17	538,769	538,769
Rezerva statutore	17	512,954	512,954
Rezerva të tjera	17	909,719	909,719
Fitime të mbartura	18	-5,004,756	-5,302,979
Fitimi i ushtrimit		-1,576,288	8,911
Totali i kapitalit		42,633,165	45,504,754
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	19	147,942	118,969
Provizione afatgjata	20	180,000	194,589
Detyrime të tjera	21	240,099	240,099
Grante dhe të ardhura të shtyra	22	63,371	64,307
Totali i detyrimeve afatgjata		631,412	617,864
Detyrime afatshkurtra			
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	19	276,464	8,068
Llogari të pagueshme tregtare	23	10,368,352	9,131,268
Llogari të pagueshme të tjera	24	3,615,789	3,472,599
Totali i detyrimeve afatshkurtra		14,261,605	12,611,935
Totali i detyrimeve		14,893,017	13,229,899
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		57,526,182	58,734,653

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Arta Beshaj
DREJTOR I DREJTORISË SË FINANCES

Florjan Muçaj
ADMINISTRATOR

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura operative			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	25	1,894,307	3,987,281
Puna e kryer nga njesia dhe qe kapitalizohet	26	52,851	73,583
Të ardhura të tjera	27	152,012	118,179
Totali i të ardhurave operative		2,099,170	4,179,043
Shpenzime Operative			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	28	-1,320,401	-1,528,645
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	29	1,123,629	1,181,772
Shpenzime personeli	30	-1,501,512	-1,475,761
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,7	-507,370	-590,537
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	31	-432,678	0
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	32	-1,034,783	-1,839,536
Total shpenzime		-3,673,117	-4,052,707
Të ardhura/ Shpenzime financiare neto			
Të ardhura nga interes	33	2,763	2,248
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	33	-5,104	-1,202
Shpenzime të tjera financiare (neto)		0	0
Totali të ardhura/ Shpenzime financiare neto		-2,341	1,046
Fitimi/humbja para tatimit		-1,576,288	127,382
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	34	0	-118,471
Fitimi/humbja e vitit		-1,576,288	8,911
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	35	-1,295,301	0
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-1,295,301	0
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		-2,871,589	8,911

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitim i pasqyrendar	Fitim/humbje e vitit	Totali
Më 1 janar 2019	14,735,229	0	36,377,045	538,769	615,490	909,719	-6,969,602	-19,973	46,196,678
Zvogëlim i rezervës së rivlerësimit		8,361,235	-10,021,371				1,660,136		0
Transferim në fitime të mbartura			-614,759				16,460		-698,299
Te tjera transferime akt kontrolli							-19,973	19,973	0
Ndryshime të kapitalit pa regjistruar					-102,536				-102,536
Fitime/humbje të përtuqes								8,911	8,911
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin									0
Më 31 dhjetor 2019	14,735,229	8,361,235	25,740,916	538,769	512,954	909,719	-5,302,979	8,911	45,604,764
Më 1 janar 2020	14,735,229	8,361,235	25,740,916	538,769	512,954	909,719	-5,302,979	8,911	45,504,764
Emetimi i kapitalit të nënshkruar		-146,830					146,830		0
Transferime brenda seksionit të kapitalit									0
Transferim në fitime të mbartura							8,911	-8,911	0
Fitime/humbje të përtuqes								-1,576,288	-1,576,288
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			-1,437,783						-1,295,301
Më 31 dhjetor 2020	14,735,229	8,214,405	24,303,133	538,769	512,954	909,719	-6,004,756	-1,576,288	42,633,165

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukaet e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	-1,576,268	127,362
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	940,048	590,537
Shpenzime për vlerën neto të AAM	0	0
Shpenzime Interesi	5,104	1,202
	-831,135	719,121
<i>Rregullime për ndryshimet në kapitalin punues:</i>		
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-1,224,999	-914,561
Rënie/(ritje) në inventarë	-416,358	-719,234
Rënie/(ritje) në shpenzime të shtyra	43,238	-3,238
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	1,238,084	267,451
Rritje/(rënie) në detyrime të pagueshme të tjera	157,593	-9,196
Te ardhura te shtyra	-936	-1,023
	-834,513	-660,680
Tatimi mbi fitimin i paguar	-28,992	-100,100
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	-863,505	-760,780
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-63,173	-68,611
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	398	0
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jomateriale	0	0
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera	0	0
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-62,775	-68,611
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	0	0
Hua të paguara	-36,262	-9,331
Hua të arkëtuara	330,635	0
Interes i paguar	-107	-1,202
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	292,266	-10,633
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	-634,014	-839,924
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës	635,218	1,475,142
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës	1,204	635,218

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënimet Shpjeguese

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albpetrol sha(shoqëria) me NIPT J82916500U, është krijuar me vendim Nr 21158, date 08.04.1999 të Gjykatës Tiranë, sipas regjistrimit tregtar, bazuar në ligjin Nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992 "Mbi shoqëritë tregtare". Selia e shoqërisë është në adresën Patos, Fier.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë kryerjen e operacioneve hidrokarbure në përputhje me Ligjin Nr 7746, date 28.08.1993 për Kerkimin Zhvillim, Prodhimin, Trajtimin, Transportin, Magazinimin dhe Shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe çdo operacion tjetër tregtar apo shërbime që i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë. Shoqëria brenda hapsirave të parashikuara nga legjilacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion projektues – preventivues, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm e të ligjshëm në përputhje me interesat e saj. Realizimi i objektit të veprimtarisë të shoqërisë, do të bëhet nepermjet shfrytëzimit dhe zhvillimit të zonave ekzistuese naftembajtëse dhe ato gazmbajtëse të vendit, kerkimeve të reja dhe zhvillimit të blloqeve në administrim si dhe shfrytëzimit të rërave bituminoze. Praktika atributet e ish APC-se Tiranë, që kanë të bëjnë me kerkim – prodhimin e hidrokarbureve i kalojnë shoqërisë Albpetrol sh.a duke filluar nga data 01.04.2003. Furnizimin me energji elektrike të klienteve të kualifikuar. Tregtimin e energjisë elektrike. Transmetimin e gazit natyror. Shpërndarja e gazit natyror. Leje mjedisore për veprimtari me ndikim në mjedis për vendburimet e naftës në zonat Kucove, Patos-Marinez (Drize +Goran), Ballsh Hekal, Amonice Gorisht, për vendburimet e gazit në zonën Divjak – Lushnje, Frakull-Fier, Povelc Fier, Finiq –Sarand, rrjeti i transmetimit të produkteve të naftës dhe të gazit., vendburimi i rërës bituminoze Kasnic-Fier, Uzina Mekanike Kucove dhe Uzina Mekanike Patos.

Kapitali i nënshkruar i saj është 14,735,229,000 leke, i ndare në 14,735,229 aksione me vlerë nominale 1,000 leke secili. Kapitali i paguar është regjistruar në Leke.

Aksionet e Shoqërisë ALBPETROL Sh.a janë nën pronësinë e Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Drejtuësit e Shoqërisë janë si më poshtë:

- Këshilli Mbikëqyrës
- Administratori i Shoqërisë

Këshilli Mbikëqyrës i ALBPETROL sha në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare përbëhet si më poshtë:

1.	Ilia	GJERMANI	Kryetar
2.	Evis	MAMAJ	Anëtar
3.	Gentian	LIKO	Anëtar
4.	Laureta	OMERI	Anëtar
5.	Ermal	NUFI	Anëtar

Administratori i shoqërisë është Z. Florjan Muçaj

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Me vendim nr 4, date 29/04/2020, te Keshillit Mbikqyres eshte liruar nga detyra e administratorit Zj. Eriola Muka dhe me vendim nr. 5, date 29/04/2020 te Keshillit Mbikqyres eshte emeruar Z. Genti Gazheli ne detyren e administratorit te shoqerise.

Me vendim nr 14, date 28/09/2020 te Keshillit Mbikqyres te Albpetrol sha, eshte liruar nga detyra Z. Genti Gazheli dhe me vendim nr 15, date 28/09/2020, te Keshillit Mbikqyres, eshte emeruar ne detyren e administratorit te shoqerise Z. Baftjar Zeqaj.

Me vendim nr 3, date 18/03/2021, te Keshillit Mbikqyres ,eshte liruar nga detyra Z. Baftjar Zeqaj dhe me vendim nr 4, date 18/03/2021 te Keshillit Mbikqyres, eshte emeruar ne detyren e administratorit te shoqerise Z. Flamur Mato.

Me vendim nr. 7, date 30/07/2021, te Keshillit Mbikqyres, eshte liruar nga detyra Z. Flamur Mato dhe me vendim nr. 8, date 30/07/2021 te Keshillit Mbikqyres, eshte emeruar ne detyren e administratorit te shoqerise Z. Florjan Muçaj.

Veprimtaria e përditshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori, te cilit, i përkasin te gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv dhe përfaqëson shoqërinë ne marrëdhëniet me te tretet.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 1.769 punonjës (2019: 1.768 punonjës).

Shoqëria aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet 11 Njësive Operative ose qendra, te cilat përgatisin secila Pasqyra Financiare më vete dhe nxjerrin rezultat të veçantë. Në qendër, shoqëria përgatit Pasqyra Financiare përmbledhëse të bilanceve kontabël të njësive të saj. Kontabiliteti në Qendër është i informatizuar, ndërsa në njësitë vartëse mbahet në mënyre të përzier, manuale dhe të informatizuar.

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të cilat maten me vlerën e rivlerësuar.

2.3. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e parimit të vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Shumat janë paraqitur në "000" Leke përveç rasteve ku citohet ndryshe.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar në mënyrë të detajuar në shënimin 5 të këtyre pasqyrave financiare.

3. Standarde dhe interpretime të reja

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Shoqërisë.

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

3.1. Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2020, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani.

- Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).

- SNRF 9 "Instrumentet Financiarë", SNK 39 "Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiarë: Shënimet shpjeguese" - Reforma e Standardit të Normave të Interesit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020).
- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet" - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar (Standarde të Ndryshme)

3.2. Standardet e reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja të publikuara, por që ende nuk janë efektive

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2020.

- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- Ndryshime në SNRF 16, "Qirate", Konçensione të lidhura me qira në kushtet e COVID-19.
- Referencat në Kuadrin Konceptual
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)
- Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Shitja apo Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Ortakut të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri kur projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit është përfunduar).

4. Politikat më të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerë me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/Lek	123.70	121.77
USD/ Lek	100.84	108.64

4.2. Instrumentat financiarë

4.2.1 Njohja dhe çregjistrimi

Aktivët dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivët financiarë transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

4.2.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar (AC)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Shoqëria aktualisht ka vetëm aktive financiare të klasifikuara me kosto të amortizuar

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitetit financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

4.2.3 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

Aktivet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogaritë e arkëtueshmeve të tjera, që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39, bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

4.2.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare me 31 dhjetor 2020.

i) Zhvlerësimi i mëparshëm i aktiveve financiare sipas SNK 39

Në vitin paraprak, zhvlerësimi i aktiveve financiare është bazuar në modelin e humbjeve të ndodhura. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testoheshin për zhvlerësim kur kishin tregues për rënie në vlerë. Aktivi financiar, të cilat nuk ishin individualisht të rëndësishme rishikoheshin për zhvlerësim në grupe të përcaktuara në bayë karakteristikav të rrezikut të kreditit të përbashkët. Shoqëria kishte identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare deri me 31 dhjetor 2019.

ii) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Shoqërisë nuk janë ndikuar nga adoptimi i SNRF 9.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Shoqëria ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

4.2.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

4.2.6 Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

4.2.7 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

4.2.8 Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarjes duke u bazuar në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit efektiv.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Kostot e shndërrimit të inventarëve përfshijnë kostot e lidhura drejtpërdrejtë me njësitë e prodhimit, siç është puna e drejtpërdrejtë. Ato përfshijnë edhe një shpërndarje sistematike të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit fikse dhe variabël të cilat kryhen gjatë shndërrimit të materialeve në produkte të gatshme. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit fikse janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat mbeten relativisht të pandryshueshme pavarësisht vëllimit të prodhimit, si për shembull, amortizimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave dhe pajisjeve të fabrikës dhe kostot e drejtimit e të administrimit të fabrikës.

Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabël janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat ndryshojnë në mënyrë të drekte, ose thuhet të drekte, me ndryshimin e vëllimit të prodhimit, si për shembull, materialet indirekte dhe puna indirekte.

<i>Lendet e para</i>	Me koston e blerjes dhe inventari i imët kosto blerje minus konsumin e llogaritur.
<i>Prodhime ne proces</i>	Me kosto ne baze te metodës se mesatares se ponderuar
<i>Produkt i gatshëm</i>	Me kosto te planifikuar.

4.4. Aktive afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, paraqiten me vleren e rivlersuar, ne perputhje me rivleresimet e kryera në datën 1 janar 2020.

Bazuar ne raportin e rivleresimit te Aktiveve dhe testin e zhvleresimit të shoqërisë, sipas skemës kontabel që rrjedh nga procesi i rivleresimit, u kryen veprimet kontabel sipas tabelave përmbledhëse për çdo qendër të shoqërisë. Efektet financiare janë reflektuar në llogaritë financiare që prek ky proces.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Kostot përfshijnë shpenzime qe janë kryer drejtpërsëdrejti për blerjen e aktivitetit. Kostot e aktiveve te ndërtuara nga vete shoqëria, përfshijnë koston e materialeve dhe te fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër qe lidhet direkt me vënien e aktivitetit ne kushte pune, si dhe kostot e çmontimit te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendndodhjen përkatëse. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar të ardhurat monetare nga shitja me vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale, dhe njihen neto brenda zërit "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivet e rivlerësuar shiten, sasitë e përfshira në rezervën së rivlerësimit transferohen në fitimin e mbajtur, ndërsa mungesa e rivlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimit të periudhës.

ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve me baze lineare për lidhjet teknologjike, pusët e naftes, tubacione e rezervuar, mbi bazën e jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale dhe me metodën zbritëse për ndërtesat, makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës dhe kompjuterike, dhe aktivet e tjera me një norme amortizimi siç shpjegohet më poshtë. Toka dhe punimet në proces nuk amortizohen.

Norma e amortizimit vjetor është si më poshtë:

	2020	2019
Baze lineare		
Lidhjet teknologjike, pusët, tubacione	1.5%	1.5%
Metoda zbritëse		
Makineri dhe pajisje	20%	20%
Pajisje informatike e të tjera	25%	25%
Ndërtesa	5%	5%

iv) Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit, apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktive afatgjata jomateriale

i) Njohja dhe matja

Licencat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

ii) Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse duke përdorur metoden lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

4.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.6.1 Të ardhurat nga shitja e shërbimeve dhe produkteve

Të ardhurat nga shitja e naftës dhe gazit janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose të arkëtueshme, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rrugës, dhe të tjera të ngjashme). Të ardhurat nga shitja e mallrave janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose për tu arkëtuar, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat nga shitja janë vlerësuar me vlerën e drejtë të kompesimit të marre, neto nga kthimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatet. E ardhura është njohur kur rreziqet dhe të drejtat mbi produktet i kalojnë në një pjesë të rëndësishme bleresit, marrja e kompesimit është e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të maten me besueshmëri dhe nuk ka me perfshirje të vazhdueshme të drejtimit të Shoqërisë me këto produkte.

4.6.2 Të ardhurat nga Grantet

Qeveria e Shqipërisë ose/dhe Organizma Ndërkombëtare ofrojnë Grante shoqërisë në lidhje me realizimin e investimeve në infrastrukturën e rrjeteve. Fillimisht Granti njihet si detyrim në Pozicionin Financiar ndërkafq që shuma e Grantit, njihet në të ardhurat me realizimin e investimit ose shpenzimeve për realizimin e tyre. Në rastin kur ofrohen grante për mbulimin e shpenzimeve të njësisë ato njihen në të ardhura, në masën e shpenzimit të realizuar.

4.6.3 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.6.4 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.7. Grantet

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur në Pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera të përgjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale për gjatë jetës së dobishme të aktivit.

4.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shpenzimet e lindura nga qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në bazë të metodës lineare sipas kohëzgjatjes së qirasë.

4.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e bilancit kontabël, duke sjellë diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve për raportin financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimi. Diferencat e përkohshme nuk parashikohen për njohjen fillestare të aktiveve dhe pasive që nuk kanë asnjë ndikim mbi kontabilitetin apo fitimin e tatueshëm. Shuma e tatimit të shtyre bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit apo shlyerjes së shumës së akumuluar të aktiveve dhe pasiveve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit.

Një aktiv i detyrimit të shtyre njihet vetëm nëse ka të ngjarë që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion, e ndaj të cilave aktiviteti mund të përdoret. Aktivitetet e tatimit të shtyre reduktohen deri në shkallën ku nuk është më e mundur që të realizohet përfitimi përkatës nga tatimi.

4.10. Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.11. Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose të tërthortë) si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën dhe ka mundësi që do të nevojitet një fluks burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për të përmbushur detyrimin dhe në këtë mënyrë mund të behet një përlllogaritje e besueshme e shumës së detyrimit. Në rast se efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme të parasë me normën e uljes para tatimeve, e cila reflekton vlerën kohore të parasë në kushtet aktuale të tregut dhe, aty ku është e përshtatshme, normën e riskut të pasiveve specifike. Provizionet rishikohen në çdo datë bilanci dhe nëse nuk ka më mundësi për nevojën e një fluksi burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

4.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.14. Krahasueshmeria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Riklasifikimet kryhen për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit

Shoqëria kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë

5.1. Të ardhura nga kontratat hidrokarbure

Shoqëria njihet të ardhura nga kontrata hidrokarbure, sipas të cilave shoqëria përfiton produkte hidrokarbure me metodën e ndarjes së prodhimit. Në këtë proces bëhen gjykime dhe vlerësime të mbështetura në prodhimin konkret dhe në parashikimet kontraktuale. Drejtimi mendon që përlllogaritja e këtyre të ardhurave paraqet në mënyrë të besueshme detyrimet kontraktuale.

5.2. Grantet

Një numër i caktuar grantesh janë përfshirë në librat, të përfituara nga transaksione të ndryshme me donator të ndryshëm. Drejtimi analizoi destinacionin dhe dokumentacionin e këtyre granteve. Një shumë e caktuar grantesh kanë qenë dhuruar si kontribut në materiale dhe aktive. Grantet njihen si të ardhura për pjesën e amortizimit të aktiveve për të cilat janë përftuar.

5.3. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

5.4. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

5.5. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

5.6. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në shoqëri. Ndërsa masat kufizuese kanë filluar të lehtësohen ende nuk është e mundur vlerësimi i këtij efekti në flukset e parave, operacionet hidrokarbure si dhe volumet dhe cmimet e shitjes. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, shoqëria po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

Kosto	Tokë	Ndërtesa	Makinieri dhe impiante	Pajisje Informatike	Të tjera në shfrytëzim	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	8,486,149	1,677,122	24,951,533	121,697	983,164	36,219,565
Shtesa	5,304	118,546	118,546	22,835	51,249	197,934
Pakësime	-624,289	-110,963	-135,352	-1,463	-91,351	-961,955
Riklasifikime midis grupeve		11,668	37,117		-45,492	
Shtesa nga rrvlerësimi i AAM	31,903		102,116			1,831
Pakësime nga rrvlerësimi i AAM		-2,823				134,019
Gjendja më 31 dhjetor 2019	7,893,763	1,580,310	25,078,960	142,969	897,571	35,589,571
Shtesa		3,673	54,010	148	6,272	64,104
Pakësime			-344		-54	-398
Riklasifikime midis grupeve			16,594	-485	-16,099	0
Shtesa nga rrvlerësimi i AAM	357,153					357,153
Pakësime nga rrvlerësimi i AAM		-144,522	-1,974,341	-21,485	-52,313	-2,192,661
Pakësime nga sistemit i amortizimit të akumuluar		-157,571	-1,695,631	-51,147	-17,871	-1,922,221
Gjendja më 31 dhjetor 2020	8,250,915	1,281,889	21,474,238	70,000	817,506	31,894,548
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2019	0	119,076	1,211,204	23,694	1,501	1,355,475
Amortizimi i periudhës		42,644	502,451	22,251		567,347
Pakësime		-4,292	-1,511			-5,802
Riklasifikime midis grupeve		144	-6,166		6,022	0
Shtesa nga rrvlerësimi i AAM				5,201		5,201
Gjendja më 31 dhjetor 2019	0	157,571	1,705,978	51,147	7,524	1,922,221
Amortizimi i periudhës		38,872	487,639	16,136	0	482,647
Pakësime			-44			-44
Shtesa			44			44
Shtesa nga rrvlerësimi i AAM						0
Pakësime nga rrvlerësimi i AAM		-157,571	-1,705,978	-51,147	-7,524	-1,922,221
Gjendja më 31 dhjetor 2020	0	38,872	437,639	16,136	0	482,647
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2019	7,893,763	1,422,737	23,367,982	91,822	890,047	33,666,350
Gjendja më 31 dhjetor 2020	8,250,915	1,243,017	21,036,599	53,864	817,506	31,401,901

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Në zbatim të shkresës nr 8044/1, datë 25/10/2019 të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, u krye rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale për shoqërinë Albpetrol sha.

Shoqëria paraqiti pranë Këshillit Mbikqyrës relacionin për rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale, bazuar në raportin përfundimtar të ekspertëve vlerësues të jashtëm, të dorëzuar pranë shoqërisë Albpetrol sha. Ky rivlerësim është kryer në zbatim të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr 16, dhe nr. 36, lidhur me vlerësimin e "Aktiveve Afatgjata Materiale.

Vlerësimi i AAM u krye për gjëndjen kontabël të AAM sipas pasqyrave financiare të datë 1 janar 2020.

Shoqëria Albpetrol sha paraqiti në pasqyrat financiare të vitit 2020, efektet financiare të këtij procesi. Megjithatë, në 31 dhjetor 2020 Albpetrol sha, nuk i ka të regjistruara të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Shoqëria është duke vazhduar procesin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

7. Aktive afatgjata jomateriale

Aktive afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Softëare	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2019	158,431	158,431
Shtesa		
Riklasifikim midis grupeve	-1,831	-1,831
Gjendja më 31 dhjetor 2019	154,600	154,600
Pakësime nga sistemin i amortizimit të akumuluar	-45,338	-45,338
Pakësime nga rivlerësimi i AAM	-11,085	-11,085
Gjendja më 31 dhjetor 2020	98,176	98,176
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2019	-22,148	-22,148
Amortizimi i vitit	-23,190	-23,190
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-45,338	-45,338
Amortizimi i vitit	-14,723	-14,723
Pakësime nga rivlerësimi i AAM	45,338	45,338
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-14,723	-14,723
Gjendja më 31 dhjetor 2019	109,262	109,262
Gjendja më 31 dhjetor 2020	83,453	83,453

8. Aktive Biologjike

Aktivitet biologjike më 31 dhjetor 2020 në vlerën 108 mijë lekë (2019: 109 mijë lekë) përfaqësojnë aktivitet drufrutorë te Qendrës Mekanike Kuçovë.

9. Inventarë

Në këtë zë janë përfshirë materialet ndihmëse dhe lënda djegëse, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	287,674	329,556
a-Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	425,181	467,043
b-Zhvlerësimi i materialeve	-137,487	-137,487
Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	31,471	38,038
Produkte të gatshme	1,734,223	1,271,869
Mallra	1,671,784	1,669,331
Totali	3,725,152	3,308,794

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarit:

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	137,487	137,487
Rimarrje për vitin	-	-
Zhvlerësimi për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	137,487	137,487

10. Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra paraqet veprimin në zbatim të urdhërit nr 862, datë 13/12/2018 "Mbi miratimin e shpërndarjes së të ardhurave që përfitohen nga marrëveshja hidrokarbure" të miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Në bazë të këtij vendimi, drejtimi i shoqërisë nxori urdhër për transferimin e shumës prej 40,000 mijë lekë nga shoqëria Albpetrol sha te Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore Tiranë. Kjo shumë është njohur si shpenzim në rezultatit e periudhës 2020.

	2020	2019
Parapagim AKBN	0	40,000
Parapagim INSIG për siguracionin e mjeteve	0	3,238
Gjendja më 31 dhjetor	0	43,238

11. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme	18,871,912	17,943,733
Deri 1 vit	1,458,551	723,094
Mbi 1 vit	17,213,361	17,220,639
Zhvlerësimi kerkesave te arkëtueshme	(560,971)	(560,971)
Totali	18,110,941	17,382,762

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim:

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	560,971	560,971
Zhvlerësimi për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	560,971	560,971

Në këtë pozicion përfshihen të drejta për arkëtim nga shoqëria ARMO sha për shumën 11,409,148 mijë lekë (2019: 11,409,148 mijë lekë). Shoqëria ARMO nuk zhvillon më aktivitete. Gjithashtu, shoqëria ka detyrime ndaj kësaj shoqërie në shumën 6,311,724 mijë lekë (2019: 6,311,724 mijë lekë), shiko shënimin 23 të këtyre pasqyrave financiare. Të drejtat dhe detyrimet ndaj ARMO sha janë paraqitur në vlera bruto dhe nuk janë kryer kompensime.

12. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Te drejta nga kontraktoret	3,408,472	2,740,630
Zhvlerësim i kerkesave ndaj nenkontraktoreve	-200,000	-100,000
Hua te dhena	652,634	666,468
Zhvlerësim i huave te dhena	-112,880	-51,703
Aktive(kerkesa) te tjera	1,438,450	1,316,779
Deri 1 vit	129,989	130,892
Mbi 1 vit	1,233,625	1,111,051
Zhvlerësim i kerkesave te tjera	-983,254	-983,254
Totali	4,203,422	3,588,920

ALBPETROL sh.a.**Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020***(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)*

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim:

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	1,134,957	983,254
Provizione per kontraktoret HK	100,000	100,000
Provizione per huate e dhena	61,177	51,703
Gjendja më 31 dhjetor	1,296,134	1,134,957

Ne aktive te tjera, shuma 3,408,472 mijë leke, paraqet te drejtat e shoqerise, qe rrjedhin nga detyrimet kontraktuale te te treteve konform parashikimit te termave te kontratave hidrokarbure, te lidhura midis Shoqerise Albpetroi sha dhe kontraktoreve, qe duhet te ishin marre ne dorezim, por qe nuk jane levruar fizikisht ne depozitat e Shoqerise Albpetroi sha.

Hua te dhena paraqet transferime fondesh te kryera nga Albpetroi sha, ne favor te kompanive te tjera publike nepermjet kontratave te huave.

Gjate vitit 2020, posti "Hua te dhena", eshte paksuar me 13,834 mijë leke, si rezultat i shlyerjes se shumes prej 13,333 mijë leke nga AKBN dhe 500 mijë leke nga shoqeria Albgaz sha.

13. Mjete monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Banka	1,182	635,187
Arka	22	51
Totali	1,204	635,218

14. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 14,735,229 mijë lekë (2019: 14,735,229 mijë lekë) i zotëruar 100% nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Numri aksioneve	14,735,229	14,735,229
Vlera nominale (në lekë)	1,000	1,000
Totali (në mijë lekë)	14,736,229	14,735,229

15. Primet e lidhura me kapitalin

Primet e lidhura me kapitalin me 31 dhjetor 2020 paraqiten në vlerën 8,214,405 lekë (2019: 8,361,235 lekë), kjo vlerë përfaqëson koston historike të tokës për të cilin nuk disponohet një dokument hipotekor dhe për këtë arsye, në momentin e themelimit të shoqërisë, nuk janë përfshirë në kapitalin ligjor por janë paraqitur si prime.

Primi i lidhur me kapitalin me 31.12.2020, paraqitet:

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	8,361,235	0
Transferuar nga llogaria "Rezerva Rivleresimi"		8,361,235
Transferuar nga llogaria "Fitim dhe humbje të mbartura", pronat Servcom dhe NRFISH	75,142	
Transferuar nga llogaria "Fitim dhe humbje të mbartura", prona, kompesuar nga Armo sha	-221,971	
Gjendja më 31 dhjetor	8,214,405	8,361,235

16. Rezerva rivleresimi

Rezerva rivleresimi më 31 dhjetor 2020 në vlerën 24,303,133 mijë lekë (2019: 25,740,916 mijë lekë). Zvogelimi i llogarise Rezerva Rivleresimi paraqitet si me poshte:

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	25,740,916	36,377,045
Sistemim me llogarine Prime të lidhura me kapitalin për vlerën historike të tokës		-8,361,235
Zvogelime të tjera		-7,555
Zvogelimi i kapitalit për vlerën e pasurive pjesë përberëse NRFISH		-570,854
Zvogelim kapitali për vlerën asetëve transferuar shoqërisë "Algaz" sha		-36,249
Sistemim me llogarine "Fitim dhe humbje të mbartura"	-142,482	-1,660,136
Nga rivleresimi AAM	-1,160,448	
Për mbulimin e ujes së rivleresimit të njohur me parë në humbje	-134,853	
Gjendja më 31 dhjetor	24,303,133	25,740,916

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

17. Rezervat e kapitalit

Rezerva ligjore me 31 dhjetor 2020 paraqitet në shumën 538,769 mijë lekë (2019: 538,769 mijë lekë).

	2020	2019
Gjendja më 1 Janar	538,769	538,769
Gjendja më 31 dhjetor	538,769	538,769

Rezerva statutore me 31 dhjetor 2020 paraqitet në shumën 512,954 mijë lekë (2019: 512,954 mijë lekë si vijon:

	2020	2019
Gjendja më 1 Janar	512,954	615,490
Zvogelimi i kapitalit për vlerën e pasurive pjese perberese te NRFISH transferuar		-92,732
Zvogelim kapitali për vlerën asetëve transferuar shoqërisë "Albgaz" sha		-9,804
Gjendja më 31 dhjetor	512,954	512,954

Gjatë periudhës 2018 është realizuar procedura për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit ligjor të shoqërisë nëpërmjet përfshirjes së asetëve të marra nga kontraktorë hidrokarbure për shumën 615,490 mijë lekë. Gjatë periudhës 2019 janë kryer procedurat e vlerësimit për zvogëlimin e kapitalit ligjor sipas përshkrimeve në tabelën më sipër. Asnjë nga këto procedura nuk është finalizuar me depozitim në regjistrin tregtar në QKB.

Rezerva të tjera me 31 dhjetor 2020 paraqiten në shumën 909,719 mijë lekë (2019: 909,719 mijë lekë). Këto rezerva përfaqësojnë fitime të pashpërndara nga periudha të kaluara, të ngelura pa u destinuar nga aksionari.

	2020	2019
Gjendja më 1 Janar	909,719	909,719
Gjendja më 31 dhjetor	909,719	909,719

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

18. Fitim/(Humbjet) e mbartura

Fitim/(Humbjet) e mbartura më 31 dhjetor 2020 janë vlerën (5,004,756) mijë lekë (2019: (5,302,979) mijë lekë), paksuar me 298,223 mije leke.

Pakesimi i fitimit të pashpërndarë me 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	-5,302,979	-6,959,602
Efekti i veprimëve të zvogelimit të kapitali për asetet kaluar Albgazit		11,284
Rillogaritja e konsumit të inventarit të inet për vitet 2015,2016,2017 QAKP		10,377
Sistemim me llogarime "Prime të lidhura me kapitalin"	146,830	
Sistemim për diferenca e amortizimit të llogaritur mbi bazen e vlerës së rivlerësuar të aktivitetit dhe amortizimit të llogaritur në fakt për vitet 2015, 2016 dhe 2017.		-5,201
Sistemim me llogarime "Diferenca rivlerësimi"	142,462	1,660,136
Rezultati vfi paraardhës	8,911	-19,973
Gjendja më 31 dhjetor	-5,004,756	-5,302,979

19. Hua bankare

Huatë afatgjata me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
E pagueshme deri 1 vit	276,463	8,068
E pagueshme mbi 1 vit	147,942	118,969
Totali	424,405	127,037

Shoqëria ka dy hua të quajtura kredia Italiane dhe Kredia Superiore. Japim informacione për secilën në vijim.

1-Kredia italiane

Ndermjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Institutit Qendror për Kreditin Afatmesëm SPA, është lidhur Marreveshja Financiare për Programin e Mbeshtetjes së Bilancit të Pagesave me vlerë 22 miliardë lireta (Projekti COMM 98-FROT/AID-98/001/00) konvertuar në euro, e administruar nga Banka Kombëtare Tregtare për AlbpëtroL sh.a. dhe ish Servcom sh.a. Kjo hua paraqitet në dy nga njesitë e AlbpëtroL në Qendren e Furnizimit të Materialeve dhe në Qendren e Sherbimeve Gjeofizike Patos (ish Servcom).

ALBPETROL sh.a.**Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020***(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)*

Paraqesim në vijim kredinë italiane të detajuar sipas maturimit.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
E pagueshme deri në 1 vit (kredi italiane)	73,731	8,068
E pagueshme mbi 1 vit (kredi italiane)	51,925	118,969
Totali	125,656	127,037

E shprehur në monedhen Euro, detyrimi në total për kredinë italiane është 1,015,817 Euro, nga të cilat 536,083 Euro është detyrimi ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për likuidimet që kjo Ministri ka kryer për shoqërinë Albpetrol sh.a. Në vijim ndarja e kredisë sipas destinacionit të shlyerjes e shprehur e përkthyer në Lek.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Banka Kombëtare Tregtare	58,343	65,719
Ministria Financave dhe Ekonomisë	66,313	61,317
Totali	126,668	127,037

2-Kredia Superiore

Ndermjet Shoqërisë Albpetrol sh.a dhe Bankes Amerikane të Investimeve, është lidhur kontratë kredie bankare me qëllim pagimin e pagave të punonjësve të shoqërisë, sipas skemës së garancisë së ofruar nga qeveria shqiptare si pasojë e paketës mbështetëse për subjektet e prekura nga masat e jashtëzakonshme të marra në kuadër të pandemisë Covid-19.

Garancia shtetërore është garancia e dhënë nga qeveria shqiptare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 277, datë 06.04.2020, ndryshuar me VKM nr 370, datë 06.05.2020, për pagat e subjekteve të prekura nga masat e ndërmara nga qeveria për menaxhimin e situatës së krijuar si pasojë e Covid -19 dhe për përfitimin e të cilit shoqëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Mirebesimit.

Paraqesim në vijim detaje mbi kredinë superiore.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
E pagueshme deri 1 vit (kredi superiore)	202,732	
E pagueshme mbi 1 vit (kredi superiore)	96,017	
Totali	298,749	0

20. Provizione

Provizionet më 31 dhjetor 2020 në shumën 180,000 mijë lekë (2019: 194,589 mijë lekë) përfaqesojnë vlerën e provizioneve për rreziqe të ndryshme. Në vijim paraqesim lëvizjet për periudhën.

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	194,589	80,000
Rimarrje e provizioneve të realizuara, të krijuara në periudha të kaluara	-114,589	
Krijim provizione për rreziqe gjyqësore	100,000	114,589
Gjendja më 31 dhjetor	180,000	194,589

Vlera prej 80.000 mijë leke nga periudha të kaluara përfshin shumën prej 50,000 mijë lekë provizione për çështje gjyqësore në proces si dhe shumën prej 30,000 mijë leke, e cila trashëgohet nga bashkimi me perthithje i Uzines Mekanike Patos dhe Transnafta Patos me Shoqërinë Albpetrol sha, respektivisht 15,000 mijë lekë Uzina Mekanike Patos (QSHGJ) si dhe 15,000 mijë lekë Qendra e Furnizimit dhe Transportit (QFT Patos).

21. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kundërparti AAM pa përfshirë në kapital	140,753	140,753
Kundërparti për asete pa vlerë përdorimi	337	337
Kundërparti për asetet e Nj.Z.I. në privatizim	99,009	99,009
Total	240,099	240,099

Shuma 140,753 mijë lekë paraqet fondin Kundërparti AAM për asetet e Nj.Z.I (në privatizim), në momentin e bashkimit të Albpetrol me Uzinat Mekanike. (Raporti i zmadhimit të kapitalit të Albpetrol sha që vjen nga bashkimi me perthithje të shoqërisë Albpetrol sha të Uzines Mekanike Patos dhe Uzines Mekanike të Naftes Kucove).

Shuma 337 mijë leke paraqet fondin k/parti për asete pa vlerë përdorimi të QMN Kucove (Uzina Mekanike Naftes Kucove), të trashëguar nga momenti i shkeputjes nga shoqëria Servcom sha.

Shuma 99,009 mijë lekë paraqet vlerën e aktiveve në Trasnafta Patos, që nuk gjenerojnë të ardhura. Mospërfshirja në shumën e zmadhimit të kapitalit të vlerës së këtyre aseteve është motivuar nga fakti se këto aktive nuk do të shërbejnë aktivitetit të ardhshëm të kompanisë. Baza ligjore e këtij veprimi është VKM nr. 784, dt. 15/09/2006, pika 6 (raporti i zmadhimit të kapitalit të Albpetrol sha që vjen nga bashkimi me perthithje të shoqërisë Albpetrol sha, Servcom sha Fier dhe Transnafta Patos).

22. Grante dhe të ardhura të shtyra

Grante dhe të ardhura të shtyra më 31 dhjetor 2020 në vlerën 63,371 mijë lekë (2019: 64,307 mijë lekë) paraqet grantet e përfituara nga shoqëria për aktive afatgjata materiale. Grantet janë njohur ne te ardhura ne menyre sistematike gjate periudhes kontabel. Paksimi neto i tyre per vitin 2020 ne shumen 936 mijë lekë (2019: 1,023 mijë lekë) pasqyrohet në Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve siç detajohet në shënimin “Të ardhura të tjera”.

23. Llogari te pagueshme tregtare afatshkurtra

Llogari te pagueshme tregtare afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2019
Furnitore te papaguar	10,307,953	9,078,942
Debitore,kreditore te tjere	61,399	52,328
Totali	10,369,352	9,131,268

Në këtë pozicion përfshihen edhe detyrime ndaj shoqërisë ARMO sha për shumën 6,311,724 mijë lekë (2019: 6,311,724 mijë lekë). Shoqëria ARMO nuk zhvillon më aktivitete. Gjithashtu, shoqëria ka edhe të drejta për arkëtim ndaj kësaj shoqërie në shumën 11,409,148 mijë lekë (2019: 11,409,148 mijë lekë), shiko shënimin 11 të këtyre pasqyrave financiare. Të drejtat dhe detyrimet ndaj ARMO sha janë paraqitur në vlera bruto dhe nuk janë kryer kompensime.

24. Llogari të pagueshme të tjera

Llogari te pagueshme të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga personeli	100,867	0
Detyrim sigurime shoqerore dhe shendetsore	26,210	23,477
Tatim Fitimi	161,314	190,307
TVSh per tu paguar	52,626	5,876
Tatimi mbi te ardhurat	8,548	7,227
Tatim ne burim	687	1,165
Renta minerare	30,441	9,451
Gjoha dhe interesa te ilogaritura	352,129	352,129
Dividende per t'u paguar	2,882,967	2,882,967
Totali	3,616,788	3,472,599

25. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Nga shitja e naftes	521,175	2,634,401
Nga shitja e gazit	4,602	13,514
Nga shitja e energjisë	1,359,307	1,332,178
Sherbime të tjera	9,223	7,188
Totali	1,894,307	3,987,281

26. Puna e kryer nga njesia dhe që kapitalizohet

Puna kryer nga njesia dhe e kapitalizuar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Puna e kryer nga njesia dhe që kapitalizohet	52,851	73,583
Totali	52,851	73,583

27. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Qera e zakonshme	3,130	4,854
Shitje skrapit	0	49,190
Konsum vetjak	60	234
Teprica inventari	18	978
Shitje sherbime	442	1,783
Gjyba, penalitete	1,983	13,934
Arketim debitorësh	0	0
Te ardhura të tjera	30,854	46,183
Rrimarje provizionesh	114,589	0
Te ardhura nga grandet	936	1,023
Totali	162,012	118,179

28. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lende e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 në vlerën 1,320,401 mijë lekë (2019: 1,528,645 mijë lekë) paraqet shpenzimet që kryen për blerje të energjisë elektrike, si dhe materiale të tjera të konsumueshme që nevojiten gjatë procesit të prodhimit dhe detajohen si vijon.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime energji elektrike	1,146,788	1,160,815
Shpenzime materiale	173,613	367,830
Totali	1,320,401	1,528,645

29. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi i gjendjes së produktit të gatshëm dhe prodhimit në proces për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	1,123,629	1,181,772
Totali	1,123,629	1,181,772

Gjendja e produktit të gatshëm dhe në proces me:

	2020	2019
Gjendja e produktit më 1 janar	1,309,907	582,222
Gjendja e produktit më 31 dhjetor	1,765,694	1,309,907
Rritja në gjendjen e inventarin të produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	455,787	727,685
Rritja e produktit të padorëzuar nga kontraktoret HK	667,842	444,488
Të tjera, produkt i palevizshëm	0	9,601
Balanca me 31 dhjetor	1,123,629	1,181,772

30. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime për paga	1,322,806	1,305,061
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	178,706	170,700
Totali	1,501,512	1,475,761

Shpenzimet e personelit perbehen nga pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore. Numri mesatar vjetor i punonjesve per vitin 2020 eshte 1,686 punonjes dhe per vitin 2019 ishte 1,775 punonjes.

31. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

Paraqitet efekti neto i rënies së vlerës së Aktiveve Afatgjata që ka rezultuar nga vlerësimi dhe paraqitja e tyre me vlerën e drejtë.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Rënia vlere nga vlerësimi	688,146	
Rritje vlere nga vlerësimi	-253,467	
Totali	432,679	0

32. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Renta minerare	52,743	264,813
Gjoha dhe demshperblime	190,570	157,227
Takse dhe tarifa vendore	241,910	205,012
Shpenzime arbitrazhi	11,232	124,008
Shpenzime transporti per materiale	12,071	54,588
Vlera kontabel neto e AAM-ve		98,364
Shpenzime auditim bilancit dhe te tjera	26,100	76,875
Shpenzime ruajtje objekti	79,679	61,168
		42/49

ALBPETROL sh.a.**Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020***(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)*

Sistemim tatimesh		133,812
Provizione dhe zhvleresime	261,177	266,291
Punime e shërbime nga të tjerë	703	20,515
Sigurim jete dhe pasurie	20,879	13,750
Kontroll pasje konformiteti	180	18,711
Sigurim magazina fiskale	14,939	12,590
Konsum vetjak	60	234
Blerje te pastakueshme (solar,vaj kompresori)	7,914	14,918
Shpenzime per objekte dhe mjete me qera	7,333	4,005
Transferime, udhetime e dieta	1,323	9,740
Regjistrim pasurie	406	21
Taksa aktpadi	541	916
Shpenzime transporti per personelin	14,806	23,542
Te tjera	5,918	11,726
Subvencione te dhena	10,000	960
Shpenzime monitorim mjedisi	3,239	9,885
Taksa e regjistrimit	6,179	5,425
Personal jashte njesise	1,758	2,448
Siguracion automjetesh	4,878	5,235
Publicitet, reklama	2,717	948
Ndihma ekonomike	1,470	6,835
Shpenzime per pritje e perfaqesime.	724	3,758
Shpenzime postare e telekom.	3,361	3,728
Shpenzime te tjera	40,000	17,811
Kerkime dhe studime	2,259	2,440
Trajtime te pergjithshme (energji,uje)	1,476	1,034
Mirembajtje, riparime	1,216	945
Shpenzime per leje Mjedisore	1,283	1,184
Shpenzime per shërbimet bankare	3,590	655
Shpenzime kalibrim rez nafte	26	760
Kancelari	126	97
Demontime	0	2,181
Inventar i imet jashte perdorimit	0	403
Totali	1,034,783	1,639,536

33. Të ardhura dhe shpenzime interesi dhe të ngjashme

Të ardhura dhe shpenzime interesi dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga interesat	-410	-1,058
Te ardhura nga konvertimi	-2,353	-1,190
Shpenzime nga konvertimi	5,103	1,202
Totali	2,340	-1,048

34. Tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Rezultati para tatimit (Fitimi / Humbje)	-1,576,288	127,362
Shpenzime të panjohura	939,190	662,425
Rimarrje provizione	-114,589	0
Rezultati tatimor i ushtrimit (Fitim / Humbje)	-751,687	789,807
Tatimi mbi fitimin (15%)	0	-118,471
Rezultati Financiar neto i periudhës	-1,576,288	8,911

35. Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin

Paraqiten efektet e rivlerësimit të Aktiveve Afatgjata. Këto efekte nuk prekin rezultatin e periudhës por fluksojnë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave gjithpërfshirëse.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Rënie vlerë asete nga vlerësimi AA, transferuar me llogarinë "Rezerva nga Rivlerësimi"	1,437,783	
Rritje vlerë nga vlerësimi AA, transferuar me llogarinë "Fitime të pashpërdara"	-142,482	
Totali	1,295,301	0

36. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Drejtimi i lartë i Shoqërisë mbikëqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Provizionet për kërkesat tregtare të vonuara njihen duke u bazuar në vlerësimet e shumave të parikuperueshme në baze të eksperiencës së mëparshme në mosarëtim nga klientët dhe një analize e pozicionit financiar të palës tjetër. Shoqëria vlerëson rrezikun e cilësisë së kreditit të debitorëve dhe vlerëson limitet e kreditit sipas secilit prej tyre.

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrime.

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2020	0-12 muaj	1-5 vjet	Me tepër se 5 vjet	Totali
Aktive financiare				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	1,204			1,204
Llogarile e arketueshme	1,588,540	1,116,139	19,609,685	22,314,364
Aktive financiare gjithsej	1,589,744	3,600,097	17,125,727	22,315,568
Detyrime financiare				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perilogaritura	1,368,993	720,307	11,165,019	13,252,319
Detyrime ndaj personelit	100,867			100,867
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	279,826	352,129		631,955
Huamarrje afatshkurter	276,463			276,463
Huamarrje afatgjata		8,953	138,989	147,942
Grante			63,371	63,371
Detyrime financiare gjithsej	2,024,150	1,402,131	11,046,637	14,472,918
Hendeku i maturitetit	-434,406	2,197,965	6,079,091	7,842,650

2019	0-12 muaj	1-5 vjet	Me tepër se 5 vjet	Totali
Aktive financiare				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	635,218			635,218
Llogarite e arketueshme	1,392,965	2,452,990	17,125,727	20,971,682
Aktive financiare gjithsej	2,028,183	2,452,990	17,125,727	21,606,900
Detyrime financiare				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perilogaritura	283,427	886,532	10,844,277	12,014,235
Detyrime ndaj personelit				0
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	237,504	352,129		589,633
Huamarrje afatshkurter	8,068			8,068
Huamarrje afatgjata			118,969	118,969
Grante			64,307	64,307
Detyrime financiare gjithsej	528,998	1,238,661	11,027,553	12,795,212
Hendeku i maturitetit	1,499,185	1,214,329	6,098,174	8,811,688

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmer transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2020	LEK	EUR	USD	GBP	Totali
Aktive financiare					
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	1,251	-16	-33	2	1,204
Llogarite e arketueshme	16,495,432	9,405	3,809,527		22,314,364
Aktive financiare gjithsej	18,496,682	9,390	3,809,494	2	22,315,588
Detyrime financiare					
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura	12,741,923	148	510,248		13,252,319
Detyrime ndaj personelit	100,867				100,867
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	631,955				631,955
Huamarrje afatshkurter	202,732	73,731			276,463
Huamarrje afatgjata	98,017	51,925			147,942
Grante	63,371				63,371
Detyrime financiare gjithsej	13,836,865	125,806	510,248	0	14,472,918
Pozicioni valutor neto	4,659,817	-116,415	3,299,246	2	7,842,650

2019	LEK	EUR	USD	GBP	Totali
Aktive financiare					
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	632,048	1,705	1,463	2	635,218
Llogarite e arketueshme	20,940,784	69	30,830		20,971,582
Aktive financiare gjithsej	21,572,832	1,773	32,293	2	21,606,900
Detyrime financiare					
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura	12,010,202	1	4,032		12,014,235
Detyrime ndaj personelit					0
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	589,633				589,633
Huamarrje afatshkurter		8,068			8,068
Huamarrje afatgjata		118,969			118,969
Grante	64,307				64,307
Detyrime financiare gjithsej	12,664,142	127,038	4,032	0	12,795,212
Pozicioni valutor neto	8,908,690	-125,265	28,261	2	8,811,688

Analiza e ndjeshmërisë së monedhës së huaj

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit dhe një korigjim i vlerave të tyre i bërë për një 5% ndryshim në kurset e këmbimit. Vlera pozitive/negative tregojnë rritje/ulje në fitim ose në kapital që ndodh kur leku dobësohet/forcohet në vlerën e tij kundrejt monedhave të huaja me +/- 10%.

37. Transaksionet me palët e lidhura

Palë e lidhur konsiderohet një entitet që ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Një numer i caktuar transaksionesh me palë të lidhura janë ndermarrë gjatë aktivitetit operacional të shoqërisë. Këto transaksione janë bërë sipas afateve dhe normave të tregut.

Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si vijojnë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrime		
Ministria Financave dhe Ekonomisë	2,882,967	2,882,967
Totali	2,882,967	2,882,967

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime		
Shpenzime për shpërbilimet e Keshillit Drejtimit	0	140
Shpenzime për shpërbilimin e administratorit	0	266

38. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

39. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të cilat do të kërkonin korigjim të pasqyrave financiare të ndodhura midis datës së raportimit 31 dhjetor 2020 dhe datës së autorizimit të këtyre pasqyrave financiare.